

**RREGULLORE**  
**PER ORGANIZIMIT TE STUDIMEVE**  
**“MASTER I NIVELIT PARE” (MNP) JURIST I PERGJITHSHEM**

**KREU I**

**Dispozita te pergjithshme**

**Neni 1**

Prane Fakultetit te Drejtesise Justiniani i I, organizohen studimet pasuniversitare “Master i Nivelit te Pare” (MNP) Jurist i pergjithshem .

**Neni 2**

**Objektivat**

Qellimi i studimeve pasuniversitare “Master i Nivelit te Pare” (MNP) ne Shkencat Juridike, si jurist i pergjithshem eshte formimi i thelluar shkencor dhe profesional ne shkencat juridike.

**Neni 3**

**Organizimi i studimeve**

Programi i studimeve pasuniversitare zhvillohet ne sistemin me kohe te plote. Programi i studimeve te ketij “ Masteri” realizohet me 60 kredite, ne perputhje me planin mesimor propozuar nga Fakulteti i Drejtesise dhe miratuar nga Senati i Justinianit te I. Programet e Studimeve “Master i Nivelit te Pare” (MNP) zhvillohen ne gjuhen shqipe.

## **KREU II**

### **Menyrat e pranimit**

#### **Neni 4**

Pranimi ne programin e Studimeve Pasuniversitare “Master i Nivelit te Pare” (MNP), behet kryesisht me konkurs, ne perputhje me numrin e kuotave te miratuara “Master”.

#### **Neni 5**

Kandidati per studime pasuniversitare master duhet te plotesoje kriteret e meposhtme :

1. a) Te jete mbajtes i diplomes “ Jurist “ te sistemit te vjeter te studimeve juridike ne Fakultetin e Drejtesise;
- b) Te jete mbajtes i diplomes te nivelit te dyte ( DND ) , ose Mbajtes i nje titulli tjeter te studimeve te barazvlefshme me diplomat e mesiperme dhe te njohur e ekuivalentuar nga organet perkatese
- c) Te kete nje DNP ne drejtesi .
2. Te kete rezultate te mira te notes mesatare minimale

#### **Neni 6**

##### **Dokumentat per pranim**

Kandidati per studime pasuniversitare “Master “ duhet te paraqese dosjen per aplikim e cila duhet te permbaje dokumentat si me poshte :

- Kerkesen e motivuar per vazhdimin e studimeve pasuniversitare “Master “ ;
- Kopje te noterizuar te diplomes se shkolles se larte;
- Certifikate notash origjinale te shkolles se larte;

- 2 rekomandime nga pedagoge ;
- C V te detajuar ;
- Ne rast se ka, Certificate e mbrojtjes te nje prej gjuheve te huaja perendimore ;
- Certificate personale me fotografi;
- Mandat-pagesen e kuotes se regjistrimit.

### **Neni 7**

Afati perfundimtar i pranimit te kerkesave per kete master, caktohet nga Komiteti Shkencor i ketij masteri dhe nuk mund te jete me pak se 2 jave.

### **Neni 8**

#### **Procedurat e perzgjedhjes**

Perzgjedhja e fituesve behet nga nje komision i caktuar nga Fakulteti i Drejtesise , ne perberje te te cilit eshte edhe Komiteti Shkencor i ketij Masteri. Kryetari i Komisionit eshte kordinatori i komitetit shkencor. Numri i anetareve te komisionit duhet te jete gjithnje numer tek dhe jo me i vogel se tre.

Metoda e perzgjedhjes konsiston ne perzgjedhjen nepermjet konkurimit te dosjeve. Kriteret e vleresimit vendosen nga komisioni perzgjedhes. Kane perparesi ne vleresim:

- mesatarja e notave te fakultetit;
- botime ne fushen juridike, te kandidatit;
- trajnimet e tij profesionale, kryesisht ne drejtimin civil;
- CV e tij, etj.

### **Neni 8**

Kur komisioni e vlereson te nevojshem, mund te therrase per interviste te gjithë kandidatet ose ata qe e sheh te arsyeshme. Komisioni vendos kriteret per

vleresimin e kandidateve. Ai vendos me shumice te thjeshte per perzgjedhjen e kandidateve fitues. Vendimi i tij duhet te merret jo me vone se 5 dite nga mbarimi i afatit te paraqitjes se kerkesave nga kandidatet.

### **Neni 9**

Komisioni shpall listen e kandidateve fitues ne stendat e fakultetit ne nje date te deklaruar me pare kandidateve.

## **ANKIMI**

### **Neni 10**

Pas shpalljes se kandidateve fitues Komisioni merr ne shqyrtim ankimet dhe u jep pergjigje atyre brenda 48 oreve. Ne se kandidati i ankimuar mbetet akoma i paqarte nga pergjigja e dhene nga komisioni perzgjedhes, ceshtja i kalon per shqyrtim mbledhjes se Keshillit te Fakultetit, i cili merr vendim perfundimtar lidhur me ankimin.

### **Neni 11**

Mbledhja e Keshillit Shkencor te Fakultetit qe merr ne shqyrtim ankimimet, thirret jo me vone se 7 dite nga paraqitja e ankimit qe i drejtohet Keshillit.

### **Neni 12**

#### **Regjistrimi**

Lista perfundimtare afishohet. Nje kopje e saj, e firmosur nga te gjithet anetaret e komisionit perzgjedhes, i jepet sekretarise se programit te studimeve "Master" per te filluar procedurat e regjistrimit.

### **Neni 13**

Studimet ne programin e masterit kryhen kundrejt pageses (tarifa e studimit ne master). Kandidatet fitues regjistrohen me nje dokument identifikimi. Ne momentin e regjistrimit, duhet te paraqitet dhe mandat-pagesa qe verteton shlyerjen e kesit te pare te tarifes se studimit.

Ne momentin e regjistrimit, studentit i jepen programet e lendeve qe do te zhvilloje ne master.

### **KREU III**

#### **Procesi mesimor**

#### **Neni 14**

Komiteti Shkencor i "Master i Nivelit te Pare " (MNP) Jursit i pergjithshem , ndjek gjithe procesin, qe nga fillimi dhe deri ne perfundim te tij. Ky komitet merr vendime qe kane te bejne me ecurine dhe mbarevajtjen e programit te masterit. Koordinator i zgjedhur nga ky komitet eshte personi pergjegjes per administrimin e gjithe procesit.

#### **Neni 15**

Koordinatori i propozon Komitetit ditet dhe oraret ne te cilat do te zhvillohet mesimi. Pas miratimit nga Komiteti, koordinatori ia percjell ato Dekanatit te Fakultetit. Me miratimin nga Dekanati, ato behen perfundimtare.

#### **Neni 16**

Mesimdhenia ne modulet e formimit, realizohet nga ekipi akademik, i miratuar nga Departamenti. Mesimi organizohet ne leksione apo forma te tjera qe pedagoget perkates i konsiderojne te vlefshme.

#### **Neni 17**

Cdo kerkese qe kane studentet depozitohet ne sekretarine e masterit dhe i kalon per shqyrtim koordinatorit. Ne se zgjidhja e problematikave te ndryshme nuk arrihet nga koordinatori dhe Komiteti Shkencor i masterit, ato mund te paraqiten ne Dekanat.

### **Neni 18**

#### **Frekuentimi**

Studentet, si rregull, duhet te frekuentojne jo me pak se 80 % te oreve te zhvilluara ne auditor per secilen lende. Perjashtimet nga ky rregull behen, me propozim te Komitetit Shkencor te masterit, nga Dekanati (ose Keshilli Shkencor) dhe vetem ne raste teper te vecanta e te motivuara.

### **Neni 19**

#### **Menyrat e kontrollit te njohurive dhe aftesive**

Menyrat e kontrollit te njohurive dhe aftesive jane ato qe parashikohen ne programin e studimeve (MNP). Vleresimi i njohurive dhe aftesive behet, qofte nepermjet formave te ndryshme te kontroleve te vazhdueshme (kontrolli i vazhdueshem), qofte nepermjet provimeve perfundimtare (kontrolli perfundimtar). Ne rastet kur zbatohet si forme provimi me shkrim duhet te respektohet parimi i anonimatit. Niveli i notave ne vleresim eshte si ne cdo nivel tjeter.

### **Neni 20**

#### **Riprovimet**

Per studentet qe nuk klasifikohen ne sezonin e pare te provimeve, do te zbatohen rregullat e percaktuara ne Statutin dhe Rregulloren Universitetit.

### **Neni 21**

#### **Diplomimi**

Ne perfundim te programit te studimeve, studenteve u jepet perkatesisht diploma “Master i Nivelit te Pare” (MND), sipas modelit bashkengjitur. Bashkengjitur frontespici .

## **KREU IV**

### **Nderprerja e studimeve dhe transferimi i krediteve**

#### **Neni 22**

##### **Nderprerja e studimeve**

Ne se studenti nderpret apo kerkon te nderprese studimet, ai, me miratim te Komitetit Shkencor, ka te drejten te rivazhdoje studimet ne vitin pasardhes.

Ne se ky program masteri nuk vazhdon me, ai ka te drejte t’i transferoje kreditet e marra ne kete program, ne nje program tjeter “Master i Nivelit te Pare” (MNP), kur ato jane te transferueshme. Ky transferim behet me miratim te Komitetit Shkencor te “Masterit”.

##### **Transferimi i krediteve**

#### **Neni 23**

Kreditet e marra ne kete master mund te transferohen ne nje program tjeter “Master i Nivelit te Pare” (MNP), kur ne te zhvillohet e njejta lende, me te njejtin program. Per transferimin eshte e nevojshme te merret nje vertetim nga Kordinatori i ketij masteri, i shoqeruar nga programi i lendes qe kerkohet te transferohet. Vertetimi duhet te permbaje emertimin e lendes, programin ne te cilin zhvillohet, si dhe kreditet perkatese.

#### **Neni 24**

Ne kete master mund te transferohen edhe kredite nga programe te tjera "Master i Nivelit te Pare " (MNP). Ne kete rast duhet te paraqitet nje dokument qe te tregojte lenden qe kerkohet te transferohet, numrin e krediteve, programin konkret te lendes, si dhe vleresimin e marre nga ai ne ate lende. Komiteti Shkencor i ketij masteri, pasi merr ne shqyrtim dokumentacionin perkates, vendos ne se do te behet transferimi.

## **Neni 25**

### **Sigurimi i cilesise**

Komiteti shkencor ka per detyre qe te kontrolloje sigurimin e brendshem te cilesise ne baze te ligjit te arsimit te larte, statutit dhe rregullores se Univeristetit Justinianit te pare . Komiteti shkencor duhet qe ne baze te nje kontrolli te vazhdueshme te ndjeke cilesine e mesimdhenies dhe mbarevajtjen e ketij masteri . Kete gje duhet ta beje me ane te pyetesorev e te ndryshem per pedagoget ashtu dhe per Studenti. Nuk perjashtihet dhe forma te tjera te pranuar nga Komiteti shkencor. Kordinatori raporton per sigurimin e cilesise se ketij masteri te rektori dhe personi pergjegjes i sigurimit te cilesise ne Univeristet

## **KREU V**

### **Financimet ( hyrjet ) dhe kostot e menaxhimit ( daljet )**

## **Neni 26**

Kostot e "Master i Nivelit te Pare" (MNP) Jurist i Pergjithshem perballohen kryesisht nga te ardhurat (hyrjet) e siguruar nga tarifat e regjistrimit (aplikimit) te kandidateve, si dhe tarifat e shkollimit te studenteve te regjistruar.

Tarifat per te bere aplikimin ne programin "Master i Nivelit te Pare" (MNP) Jurist i Pergjithshem jane

- 5 000 leke per te punesuarit ne Fakultetin e Drejtesise;
- 10 000 leke per te punesuarit ne sektoret shteterore;
- 15 000 leke per te punesuarit ne sektoret private.

Mandati i arketimit dorezohet me dokumentat e aplikimit ne Departament.

### **Neni 27**

Tarifat e studimit (shkollimit) ne programin e studimeve pasuniversitare “Master i Nivelit te Pare” (MNP) jane:

- 150 000-300 000

Kjo tarife paguhet ne kater keste te barabarta. Cdo kest paguhet ne fillim te cdo semestri.

Cdo kandidat fitues nuk mund te regjistrohet per te ndjekur kete program“Master i Nivelit te Pare“ pa dorezuar mandat-arketimin e kestit te pare.

Ne se nuk shlyhet nje nga kestet e tjera, studenti nuk mund te vleresohet ne asnje nga provimet ne sezonin e radhes.

### **Neni 28**

Kostot e menaxhimit, si rregull, ndahen sipas kesaj strukture:

- Shperblimi per organizimin e programit dhe drejtimin ne tij - 10 %;
- Shperblimi per oret mesimore te personelit akademik - 60 %;
- Matriale didaktike, bibliografike etj, - 10 %;
- Blerje materialesh te inventarizueshme - 8 %;
- Shpenzime per promovimin e programit - 3 %;
- Shpenzime te tjera - 9 %.

Per ndryshimet ne kete strukture dhe cdo disponim tjeter te fondeve, vendos Komiteti Shkencor i ketij masteri, ne baze te propozimeve te argumentuara te Kordinatorit.

**KREU V**  
**Dispozita Perfundimtare**

**Neni 29**

Kjo rregullore hyn ne fuqi, menjehere pas miratimit te saj nga organet perkatese.